

VENDIM
Nr. 434, datë 6.3.2013

PËR TRANSFERIMIN E PASURIVE, TROJE DHE OBJEKTE, ME INTERES VENDOR, NË PRONËSI TË BASHKISË SË TIRANËS, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 120, DATË 4.3.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 shkronja “k”, 5, 8 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pasuritë, truall dhe objekte, me vendndodhje në zonat kadastrale 8330 dhe 8310, si dhe me indekset e hartës TR-I, J-3,4;5,6;7,8;9,10;11,12; G, H-9,10 dhe K,L-11,12, në administrim të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, të kalojnë në pronësi të Bashkisë së Tiranës, për realizimin e projektit “Zgjerimi i bulevardit të ri të Tiranës dhe rehabilitimi i lumit të Tiranës”, sipas formularëve bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Pronat e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të hiqen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr. 120, datë 4.3.2004 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryetari i Bashkisë së Tiranës dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha